



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr.909/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, i përbërë nga gjyqtaret: Ferki Xhaferi kryesues, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkritazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit Alush Shala nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Prizrenit, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

## V E N D I M

- I. Pranohet pjesërisht** i bazuar apeli Anr.909/2021, paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit Alush Shala nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Prizrenit, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, për Qendrat e Votimit QV 2014A, QV 2039A, QV2023A, në Komunën e Prizrenit.
- II. Urdhërohet** Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për kandidatët për anëtar të Kuvendit Komunal të Prizrenit, nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, në Qendrat e Votimit: QV 2014A, QV 2039A, QV2023A.
- III. Rezultati** i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në Qendrat Votimeve, të vendosura si në pikën -II- të këtij dispozitivi të këtij vendimi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.
- IV. Refuzohet e pabazuar** pjesa e apelit Anr.909/2021, paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prizrenit Alush Shala nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Prizrenit, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, për Qendrat e Votimit QV 2042A, QV 2004A, QV 2006A, QV 2008A dhe QV 2013A.

## A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidati për kuvend komunal Alush Shala nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Prizrenit në të cilën pretendon se ka parregullsi në numërimin e votave lidhur me Qendrat e Votimit QV 2014A, QV 2039A, QV2023A, QV 2042A, QV 2004A, QV 2006A, QV 2008A dhe QV 2013A. Si dëshmi ka bashkangjitur deklaratat e votuesve.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura dhe sipas hetimit të kryer nga vet PZAP, në ankesë në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

### **Apeli është pjesërisht i bazuar.**

Nga shkresat e lëndës, rezulton se kandidati për Kuvend Komunal Alush Shala nga Subjekti Politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Komunën e Prizrenit, ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve në Qendrat e Votimit QV 2014A, QV 2039A, QV2023A, QV 2042A, QV 2004A, QV 2006A, QV 2008A dhe QV 2013A, sa i përket numrit të votave për kandidat.

Paneli vlerëson se apeli është i bazuar sa i përket Qendrave të Votimit, të vendosura si në pikën -II- të dispozitivit të këtij vendimi, nga se rezulton se në Rezultatet përfundimtare nga KQZ, të Kandidateve në qendrat e votimit të apeluara kandidati për Kuvend Komunal Alush Shala nga Subjekti Politik AAK, ka gjithsej 7 vota, ndërsa sipas deklaratave të votueseve të bashkangjitura në apel e që ndërlidhen me këto QV, kemi me shumë deklaratat si dëshmi që deklarojnë se kanë votuar të njëjtin mirëpo këto vota nuk rezultojnë të jenë në rezultatin përfundimtar të shpallur nga KQZ-ja, prandaj paneli konstaton se ka mospërputhje të rezultatit përfundimtar me deklaratat e votueseve andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së e urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për qendrat e votimit e si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi..

Paneli, vlerëson se ky rinumërim e bënë procesin e numërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e numërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparenca, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Andaj PZAP nga këto arsye, dhe në mbështetje të nenit 117.4 urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimet e lartcekura. Si në pikën II të dispozitivit.

Ndërsa sa i përket pjesës refuzues, të vendosur si në pikën -IV-, te dispozitivit paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Paneli me rasti e vendosjes mori për bazë pretendimet e ankuesit se deklaratat e dorëzuar për QV-të e vendosura në pikën -IV-, të dispozitivit të këtij vendimi janë dëshmimi se ka pasur vota në ato QV, po ashtu për paneli është e qartë se në këto QV kandidati në fjalë ka pas vota dhe të njëjtat vota janë publikuar me rastin e publikimit të rezultatit përfundimtar, por me asnjë provë shpresore ankuesi në QV të vendosur në pikën IV të dispozitivit nuk i'ka argumentuar se ka parregullsi me rastin e publikimit të rezultatit apo ka me shumë vota sesa janë publikuar në rezultatin përfundimtar, sepse deklaratat e bashkangjitura për këto qendra të votimit janë më pak se sa ka vota ankuesi, e që rezulton se deklaratat për këtë pjesë nuk mund të konsiderohen të mjaftueshme, për të dëshmuar parregullsi gjatë numërimit, prandaj u vendos si në pikën IV të dispozitivit të këtij vendimi. Ndërsa sa i përket Qendrës së Votimit QV 2013A, apeli është i pa bazuar për faktin se për të njëjtën Qendër Votimit, PZAP ka marrë vendim Anr.908/2021 për rinumërimin e saj.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr.909/2021 më datën 06.11.2021



**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118, par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimin të këtij vendimi.